Përmbledhje e komenteve/rekomandimeve nga takimi me shoqerine civile

Falenderim nga këshilli i bashkisë për mendimet dhe propozimet nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në tryezën e përbashkët për antikorrupsionin, si pjesë e agjendës kombëtare për integrimin në BE.

Titulli i Takimit: Tryezë pune me përfaqësues të shoqërisë civile për antikorrupsionin **Qëllimi:** Përmiresimi i procedurave dhe instrumentave që forcojnë rolin e këshillit të bashkisë në parandalimin e korrupsionit në nivel vendor dhe angazhimin e shoqerisë civile në sinjalizimin e fenomeneve korruptive.
Takimi u organizua në datën 9 Tetor 2025, ora 10:00 ne Sallën e Keshillit të Bashkisë
Morrën pjesë 17 persona, 11 femra
Përmbledhje e sesionit: Takimi u drejtua nga n/kryetarja e këshillit të bashkisë znj. Kozeta Guci dhe kryetari i komisionit të arsimit, kulturës dhe sportit z.Pirro Kallajxhi. Ndihmoi takimin dhe znj. Lindita Oshafi, eksperte e BtF dhe sekretari i Këshillit bashkiak z. Erion Vodo. Për pjesëmarrësit u bë një prezantim i shkurtër për rolin e shoqërisë civile për një këshill bashkiak të suksesshëm në luftën kundër korrupsionit. Pjesëmarrësit u njohen me faktorët për mundësi korrupsioni dhe me rolin e këshillit bashkiak, që me vendimarrjet e tij transparente dhe me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, por dhe me llogaridhënie te përgjegjshme në menaxhimin e financave publike, të ulë mundësinë e veprimeve korruptive në nivel vendor. Pjesëmarrësit, referuar temës të takimit, bënë mjaft propozime për përmirësimin e instrumentave dhe procedurave nga këshilli i bashkisë për të rritur besimin e shoqërisë civile për të adresuar veprimet korruptive dhe për të bashkëpunuar me këshillin dhe komisionet sa të jetë e mundur për përmirësime të transparencës, hetimit të rasteve që fliten, konsultimin real me njerëzit përpara vendimarrjeve, llogaridhëniet e përgjegjshme etj dhe në interes të qytetarëve dhe gatishmerinë e tyre për të sjellë një ndryshim. **Cështjet e ngritura nga takimi me shoqërinë civile** - Nuk ka në bashki koordinator për të drejtën e informimit- që e kërkon ligji, kemi kërkuar ta takojmë, por nuk dime kush e mbulon këtë sektor me shumë rëndesi. - Ku të adresojmë ankesën për një veprim korruptiv, a kemi një procedurë të qartë që ruhet anonimati, kush do ta administrojë dhe të na kthjë përgjigje, të hetojë. Ka ndonjë procedurë të shkruar nga këshilli, që të qartesojmë e nxitim grupet që përfaqësojmë të sinjalizojnë aktet korruptive që përfliten. - Ku protokollohen kërkesat tona që kemi për këshilin e bashkisë. Adresojmë ankesa apo kërkesa për zgjidhje nga këshilli i bashkisëe dhe na kontaktojnë punonjës te bashkise, kur presim pergjigje nga keshilli i bashkise. - Jemi shume pak njerez qe po mblidhemi ne keto takime. Zyra e konsultimit publik te hartoje listen e plote te OJF te rregjistruara dhe te kerkojne nga ne dhe grupe te tjera interesi, te propozojne perfaqesues dhe figura te bashkise, per te mbuluar ne si shoqeri civile me ekspertizen tone te gjitha fushat e kompetencave qe ka keshilli i bashkise ne vendimarrjet e tij. - Mund te na organizoni nje takim ne si shoqeri civile me kryetaret e komisioneve specifike, qe te ndajme disa kerkesa konkrete dhe te krijojme nje lidhje te ngushte te perhershme per te

propozuar dhe vendosur me transparence per ceshtje qe na shqetesojne edhe ne, te sigurohemi qe ka dashamiresi qe vendimet ti marrim sebashku.
- Jemi larg konsultimeve te verteta publike qe ben bashkia apo keshilli per miratimin, ku pjese jane me shume nga administrata se nga qytetaret.
- Presim te kete nje vleresim per median, e cila e ndihmon keshillin dhe shoqerine civile te shikoje zbatimin e vendimeve dhe te informoje njerezit per nje pjesemarrje me aktive ne ceshtjet publike dhe monitorimin e sherbimeve per te zvogeluar hapesirat per korrupsion.
- Nuk e dime si eshte ne rregullore, por mire do jete qe nje kryetar bashkie, apo edhe kryetari i keshillit, per vendimarrje te rendesishme te jape konferenca shtypi, praktike qe nuk ndodh.
- Per nje vemendje dhe informacion te thjeshte dhe viziv te vendimarrjeve te rendesishme nga komisionet apo keshilli i bashkise, te kemi prezantime ne power point qe te risin interesin.
- OJF dhe grupet e interesit nuk mbeshteten fort nga Bashkia. Kerkojme miratimin e nje fondi per shqoqerine civile per zbatimin e projekteve qe kenaqin objektivat qe ka edhe bashkia ne dokumentat strategjike te zhvillimit. Keto dokumenta te miratuara edhe nga keshilli kane objektiva per rinine, kulturen, transparencen, monitorimin, grupet vulnerabel etj, pra kerkojme qe dhe ne te jemi konkurues ne kete bashki per zbatuar bashke me ta projekte qe kenaqin interesat e grupeve qe perfaqesojme, por edhe objektivat e bashkise.
- Pjesemarresit rradhiten dhe ceshtje qe nuk vleresohen nga bashkia si mungesen e burimeve njerezore te kualifikuara per menaxhimin e nje teatri me paisjet me moderne, problemet e parkimeve ne lagje, te te moshuarve qe nuk degjohen, te aktiviteteve te rendesishme me figura kulture dhe shkence, te zbulimeve arkeologjike me interes per vizitoret etj.
- Edhe buxheti nuk eshte nje dokument qe terheq vemendjen tone, kerkohet te jete i thjeshte dhe te kuptojme qe procesi ka mbeshtetur ato qe jane prioritete edhe per ne.

Rekomandime per te zgjidhur disa ceshtje bashke me keshilltaret

- Te shikohet emerimi apo ngarkimi i nje punonjesi me ceshtjet e informimit, qe ne te kerkojme e marrim informacion te thjeshte qe na duhet per cdo gje ne bashki
- Te hartohet nje procedure, si nje qytetar i thjeshte te sinjalizoje nje procedure apo person korruptiv, te sigurohet qe hetohet dhe jepet zgjidhje per denoncimin.
- Te vleresohet procedura e nje ankese qe adresohet per keshillin e bashkise dhe te rregjistrohet nga marrja e saj dhe deri ne zgjidhjen.
- Te organizohet nje takim me kryetaret e komisioneve per te siguruar lidhjen sipas fushave dhe grupeve qe ne perfaqesojme, per te qene prezent gjithmone ne vendimarrjet e tyre transparente.
- Te pasurohet lista e shoqerise civile edhe me personalitetet dhe njerez aktive, per kontribuar me ekspertizen e tyre per vendime te mira nga keshilli i bashkise.
- Ne diskutimet tani per buxhetin e vitit 2026 te shikohet mundesia e vendosjes se nje fondi per shoqerine civile , kundrejt kritereve te qarta dhe ligjore te perdorimit, ne mbeshtetje te objektivave te dokumentave sektoriale si kultura, rinia, grupet sociale etj. Edhe paketa fiskale per OJF, median re kene tarifa me te ulta se nje biznes, per vete misionin e tyre publik qe kane.
- Keshilli te pergatise shpejt kalendarin e konsultimeve publike dhe keto konsultime te jene me grupet e interesit per prioritizimin e propozimeve dhe mbeshtetjen e tyre me buxhet sipas mundesive. Pra, jo takime publike masive, ku me shume ka administrate se qytetare.
- Te rregullohet infrastruktura per prezantimin per qytetaret te vendimarrjeve te rendesishme, te blihet nje projektor i ri (fondet e keshillit, se ka fonde te pakonsumuara).